



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 18.03.2021

- Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik Florian Ballhysa, në seancën gjyqësore të datës 18.3.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr.173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 7.10.2019, është njoftuar vendimi nr.173, datë 1.7.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani, prokuror/Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kavajë.

Në datën 29.7.2019, në Institucionin e Komisionerëve Publikë është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi” (në vijim referuar Rekomandimi i ONM-së), kundër vendimit nr. 173/2019, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vlerësim të Rekomandimit, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit ka ushtruar ankim.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Madani, në mbështetje të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Mbështetur në pikën 1, të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Nisur nga rezultatet e hetimit për secilin kriter dhe nga provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur, me shumicë votash, konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani.

II.A Vlerësimi i Komisionerit Publik mbi interpretimin ligjor të Komisionit

3. Komisioneri Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson fillimisht të nënvizojë disa çështje që kanë të bëjnë me interpretimin e ndryshëm nga ana e Komisionit të dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të cilat rezultojnë të kenë gjetur trajtim nga jurisprudenca e Kolegjit. Të tilla interpretime të përdorura nga Komisioni duhet t’i nënshtrohen juridiksionit kontrollues të Kolegjit gjatë këtij gjykimi të ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik.

4. Në referencë të sa më lart, Komisioneri Publik parashtron se argumentimi dhe përfundimet e arritura nga Komisioni, në rastin konkret, nuk janë në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, tashmë të konfirmuar në disa vendime të tij, për çështje të tilla si: (i) interpretimi i dispozitës së nenit D të aneksit të Kushtetutës, për sa i përket përmbajtjes së D-Vett., në raport me DV, si dhe (ii) vlerën provuese të deklaratave noteriale gjatë hetimit administrativ në Komision, gjatë procesit të rivlerësimit.

4.1 Kolegji, në jurisprudencën e tij, ka trajtuar në disa vendime çështjen e *raportit të përmbajtjes së D-Vett. me përmbajtjen e DV*, duke sjellë në vëmendje vendimet: (JR) nr. 9/2019, (JR) nr. 6/2018 dhe (JR) nr. 7/2018, (JR) nr. 8/2018, (JR) nr. 9/2018, (JR) nr. 10/2018, (JR) nr. 12/2018, ku në vijim citohen dy prej tyre:

i. Në vendimin nr. 9/2019, prg.12.2, shprehet se: [...] *nga ana e Komisionit është bërë në interpretim të gabuar të nenit D të aneksit të Kushtetutës. Vlerësohet se nuk është qëndrim i drejtë i Komisionit kur, në interpretim të pikës 2 të kësaj dispozite, konkludon :[...] Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të pasurisë dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklarime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit[...]. Trupi gjykues sjell në vëmendje se Kushtetuta nuk duket të ketë parashikuar nga ana formale apo nga një interpretim harmonik i dispozitave përkatëse në asnjë moment vlerën (primare) të deklaratës së pasurisë (Vetting) 2017 apo të deklarimeve të pasurisë në vite. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rendin e rëndësisë së deklarimeve. Verifikimi i saktësisë dhe i plotësisë së deklarimeve të subjektit, verifikimi i dyfishit të pasurisë, si dhe i*

burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklaratimeve vlerën e provës, përbëjnë në fakt kriteret në të cilat duhet të kalojë vlerësimi i pasurive të subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës [...].

ii. Në vendimin nr. 6/2018, pika 14, shprehet se: [...] *Bazuar në përcaktimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 32, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit, nuk është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, por deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë prej tij. Deklarimet e mëparshme të pasurisë, të kryera nga subjekti i rivlerësimit përbëjnë edhe bazën e vlerësimit krahasues për ILDKPKI-në, për përgatitjen e raportit përfundimtar, bazuar në nenin 33, pika 1 e ligjit nr. 84/2016... Në kuadër të procesit të rivlerësimit, shkarkimi i gjyqtarit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, kryhet nga Komisioni pas një procesi hetimi të bazuar në prova, të cilat sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mund të jenë edhe deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja. Kontrolli i Deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, i shërben Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij[...].*

4.1.1 Me gjithë jurisprudencën e lartpërmendur të Kolegjit, në rastin konkret, Komisioni, në arsyetimin e vendimit nr.173/2019, objekt ankimi, lidhur me çështjen e raportit të D-Vett. me DV, ndër të tjera, parashtron se: [...] pika 2, e nenit D të aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzohë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillojnë të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht Deklarata “Vetting” dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të pasurisë (“Vetting”), dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklaratime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Këto pasaktësi, në deklarinë për herë të parë, nuk mund të shërbejnë si provë për të vërtetuar ndonjë qëllim të mundshëm për fshehje pasurie, për aq kohë sa është deklaruar saktë në Deklaratën “Vetting”. [...]¹.

4.2 Po ashtu nënvizojmë se Kolegji, në jurisprudencën e tij, ka trajtuar dhe çështjen e vlerës provuese të deklaratave noteriale të hartuara dhe depozituara gjatë hetimit administrativ në Komision, për efekt të procesit të rivlerësimit, konkretisht në vendimin: (JR) nr. 6/2018, (JR) nr.10/2018, ku në vijim citohen dy prej tyre:

i. Në vendimin nr. 6/2018, pika 27, prg. 3, shprehet se: [...] *Në lidhje me kontratat e shitjes së pasurisë së paluajtshme të vitit 2008, trupi gjykues vlerëson se, megjithëse subjekti i rivlerësimit është përpjekur t'i justifikojë ato me deklaratë noteriale të personit tjetër të lidhur ..., edhe nëse kjo deklaratë do të kishte përmbajtjen e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, përsëri nuk do të*

¹ Referohuni pikës 24.31, faqe 11 e vendimit të Komisionit.

kishte vlerë provuese, pasi nuk është bërë në momentin e krijimit të të ardhurave dhe nuk ka asnjë dokumentacion provues për kalimin e këtyre të ardhurave nga personi tjetër i lidhur te subjekti i rivlerësimit [...].

j. Në vendimin nr.10/2018, pika 21, shprehet se: [...] Lidhur me deklaratën noteriale të znj. ..., në cilësinë e shitëses së apartamentit, për momentin kur deklaroi se i ka kthyer mbrapsht subjektit të rivlerësimit shumën prej rreth 24.000 euro, të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe të disbursuar në llogarinë e saj bankare, nga analiza e provave të gjendura në dosje, vlerësojmë se nuk ekziston asnjë dokument bankar dhe/ose financiar apo akt noterial i kohës kur pretendohet të jetë kthyer kjo shumë, që të vërtetojë kalimin e kësaj shume te subjekti i rivlerësimit, e për rrjedhojë, nuk justifikohet as rikonstrukcioni i apartamentit në vlerën prej 13.000 euro, deklaruar nga subjekti që të jetë bërë me këto të ardhura [...].

4.2.1 Me gjithë jurisprudencën e lartpërmendur të Kolegjit, Komisioni, në arsyetimin e vendimit nr.173/2019, objekt ankimi, lidhur me vlerën e deklaratave noteriale gjatë procesit të rivlerësimit, parashtron se: [...]Referuar përgjigjeve të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se babai tij i ka dhuruar shumën prej 1,500,000 lekësh. Lidhur me këtë fakt ka dorëzuar si dokument provues deklaratën noteriale të datës ****.10.2018*²[...]. [...]Subjekti ka paraqitur si provë deklaratën noteriale të datës ****.10.2018*, sipas së cilës babai i tij, z. ****.****, deklaroi se mbi bazën e traditës familjare, me pëlqim të bashkëfamiljarëve, ka mundësuar dhënien e vlerës prej 1,500,000 lekësh djalit të tij, z. Artan Madani, pasi po kryente punimet për përfundimin e banesës së tij³[...]. [...]Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision edhe provat shkresore si: (i) dy deklarata noteriale të datës ****.6.2019*, nëpërmjet të cilave babai dhe vëllai i bashkëshortes së tij konfirmojnë deklaratimet e subjektit⁴[...].

II. B Vlerësimi mbi kontrollin e pasurisë

5. Mbajtur në konsideratë sa u parashtrua më lart, lidhur me interpretimin e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në jurisprudencën e Kolegjit, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr.173, datë 1.7.2019, në mënyrë të përmbledhur, parashtrojmë si vijon:

² Referohuni pikës 24.13, faqe 8 e vendimit të Komisionit.

³ Referohuni pikës 24.32, faqe 11 e vendimit të Komisionit.

⁴ Referohuni pikës 24.46, faqe 14 e vendimit të Komisionit.

6. (1) Pasuria nr. *, me sipërfaqe 146.46 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, rruga “***”, Durrës (në vijim referuar si “Apartament banimi 146 m²”); (2) Pasuria nr. ***, me sipërfaqe 10.5 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, rruga “***”, Durrës (në vijim referuar si “Garazh 10 m²”)**

6.1 Në *D-Vett.*, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaron: Apartament banimi me sip. 146.46 m² dhe garazh sip. 10.5 m², vlera 5.500.000 lekë dhe *burimi i krijimit*: (i) nga kursimet në vite të të ardhurave; dhe (ii) pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

6.2 Në *Deklaratën e parë (dorëzuar në datën 24.3.2004)*, subjekti ka deklaruar: apartament banimi 3+1, vlera 5.500.000 lekë dhe *burimi i krijimit*: (i) nga kursimet në vite e të ardhurave; (ii) nga pjesëtimi vullnetar i një banese në bashkëpronësi.⁵

6.3 Referuar rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, z. Madani, barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse për sa ka deklaruar mbi mënyrën e likuidimit të blerjes së apartamentit dhe përfundimit të tij, si dhe për pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të konstatuar sipas analizës financiare për vitet 1992-2003, më konkretisht mbi: (i) aftësinë financiare të z. ***.*** (babai i subjektit të rivlerësimit) për të krijuar shumën 1.500.000 lekë; (ii) aftësinë financiare të z. ***.*** (babai i bashkëshortes të subjektit të rivlerësimit), për të dhuruar në total shumën 1.000.000 lekë, të pretenduar si ndihmesë financiare nga ana e tij; (iii) faktin se nuk është deklaruar si burim krijimi i pasurisë apartament, shuma prej 300.000 lekë, në formë kryerje punimesh nga vëllai i bashkëshortes së tij, si edhe (iv) për diferencën negative në shumën - 2.042.953 lekë.

6.4 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje dhe ka paraqitur dokumentacion në materialin: “*Shpjegime ndaj rezultateve të hetimit*”, të datës 22.6.2019.

6.5 Komisioni për këto pasuri, pasi ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për dhurimet e padeklaruara, ka konkluduar se: [...] *pavarësisht se analiza financiare për periudhën 1992 – 2003 del me një balancë negative të fondeve në vlerë të vogël, nuk mund të vihet në dyshim aftësia financiare e subjektit për kryerjen e pagesave për prenotimin e këtyre pasurive dhe realizimin e shpenzimeve për përfundimin e apartamentit, kjo nisur edhe nga fakti se vlera totale e deklaruar e këtyre pasurive është e karakterit deklarativ dhe nuk disponohet ndonjë evidencë apo situacion punimesh lidhur me shpenzimet totale të kryera nga subjekti i rivlerësimit për përfundimin e apartamentit. Duhet pasur parasysh që analiza financiare para vitit 2003 nuk ka një bazë të saktë përlllogaritjeje, duke qenë se Komisioni nuk disponon të dhëna të sakta në lidhje me shpenzimet dhe koston e jetesës për person. Në këtë rast, balanca negative është -163,765 lekë për 10 vjet, pra rreth 16,000 lekë në vit, vlerë e cila mund të jetë marzhi i gabimit në përlllogaritje dhe, për këtë arsye, nuk do të merret në konsideratë. Si rrjedhim, Komisioni vlerëson se subjekti i*

⁵ Në DV-2003 nuk janë të dukshme shtypshkrimet, por konfirmohen si të tilla nga vendimi nr. 173/2019, i Komisionit, i publikuar.

rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesave për prenotimin dhe realizimin e shpenzimeve për pasuritë: Apartament + garazh [...].⁶

6.6 Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së për këtë pasuri⁷, konstaton se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa i përket: (i) gjendjes juridike të pasurisë: Apartament me sipërfaqe 146 m² në momentin e krijimit, (ii) pronësisë mbi garazhin, në deklaratën e parë të deklarimit të pasurisë. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi (iii) burimet e ligjshme të financimit për këto pasuri, si ato të deklaruara në deklaratat periodike vjetore, ashtu dhe ato të deklaruara për herë të parë gjatë hetimit administrativ, duke u konstatuar pasaktësi mbi deklarimin e çmimit të paguar për pasurinë të shoqëria ndërtuese, si dhe (iv) nuk ka arritur të justifikojë arsyet e mosdeklarimit të këtyre burimeve, si dhe/ose mundësinë financiare të dhuruesve, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur.

6.7 Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pasuria: “Apartament banimi 146 m²” është blerë në gjendje “karabina”

6.7.1 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të germës “a”, të pikës 5.1, të Rekomandimit të ONM-së⁸, nga shqyrtimi i akteve në dosje konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurisë në gjendjen karabina, gjendet i papabazuar, për arsyet në vijim:

(i) Në përmbajtjen e dy kontratave të veçanta për secilën pasuri më vete, të nënshkruara nga vetë subjekti i rivlerësimit, më datë ****.10.2004*, për blerjen e “*Apartament banimi 146 m²*” dhe “*Garazh 10 m²*”, është parashikuar shprehimisht se këto pasuri janë në pronësi të shoqërisë “******” sh.p.k. dhe figurojnë të regjistruara në regjistrin hipotekor nr. *****, datë ****.12.2001*. Nga përmbajtja e kontratave nuk rezulton të jetë parashikuar gjendja “karabina” apo “i papërfunduar” i pasurive të shitura.

(ii) “*Godina 6 +2 kate*”, ku gjenden këto pasuri, me investitor shoqëria “******” sh.p.k., është përfunduar në vitin 2000, vërtetuar me procesverbalin e kolaudimit të inxhinieres ****.****, i datës ****.10.2000*. Ky procesverbal është administruar si pjesë e dokumentacionit, që ka shërbyer për regjistrimin në ZVRPP-në Durrës. Bazuar në parashikimet e ligjit nr.7720, datë 14.6.1993, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, të ndryshuar, procesverbali i kolaudimit është garanci teknike dhe ligjore për dhënien e lejes së shfrytëzimit ose banimit të objektit.

⁶ Referohuni pikës 24.50, f. 15 e vendimit të Komisionit.

⁷ Referohuni pgr. 5.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, të Rekomandimit të publikuar.

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2019/07/9.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-dat%C3%AB-1.7.2019.pdf>

⁸ “*Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se apartamenti është blerë në gjendje të papërfunduar në momentin e krijimit, subjekti nuk arriti të shpjegojë/provojë mosdeklarimin në deklaratën e parë dhe as në kontratën e shitjes, të gjendjes së papërfunduar të apartamentit, si dhe të provojë me dokumentacion punët e kryera për përfundimin e apartamentit, si dhe identitetin e punëtorëve ose investimin e kryer. Kjo konfirmon konkluzionin se subjekti ka blerë një apartament në gjendje të përfunduar me një vlerë totale prej 5.500.000 lekë, siç deklarohet në deklaratën e parë. Kjo nënkupton që çmimi i shitjes në kontratën e shitjes, nënshkruar në nëntor 2004, është artificialisht më i ulët ...*”

(iii) Leja e shfrytëzimit (banimit), e datës ***.9.2000, me objekt: “Banesë 8 kate”, me investitor “****” sh.p.k., është lëshuar nga Zyra e Urbanistikës pranë Këshillit të Rrethit Durrës, bazuar në ligjin nr. 7720, datë 14.6.1993, dhe lejon shfrytëzimin për banim të këtij objekti.

(iv) Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.***, datë ***.8.2001, i cili ka marrë formë të prerë, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë të paditësit, shoqërisë “****” sh.p.k., duke e detyruar të paditurin, ZVRPP-në Durrës, të bëjë regjistrimin në pronësi të paditësit, banesë 8-katëshe dhe kati nën tokë, ndër të tjera, me arsyetimin se: [...] *Ndërtimi i banesës është bërë me leje të organeve kompetente shtetërore, ka përfunduar dhe është dhënë për shfrytëzim, ndërsa çështja e kateve është zgjidhur me vendim të gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë, prandaj dokumentacioni për regjistrimin e saj në ZVRPP është i plotë [...].*

(v) Deklarata noteriale (regjistrim fillestar), e datës ***.1.2001, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol. e shoqërisë “****” sh.p.k., e administratorit të saj, z. ***.***, ka objekt regjistrimin e godinës së banimit.

(vi) Vërtetimi nga dokumentet hipotekore dëshmon se shoqëria “****” sh.p.k. ka regjistruar këto pasuri, në regjistrin hipotekor nr. *** , më datë ***.12.2001.

6.7.2 Në përfundim të sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit e ka blerë pasurinë “*Apartament banimi 146 m²*”, të përfunduar plotësisht që në vitin 2000. Në këto rrethana ligji dhe fakti, mbetet i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pasuria: “*Apartament banimi 146 m²*” ishte në fazë karabinaje.

6.8 *Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pasuria: “Garazh 10m²” mendohej e lidhur me pasurinë: Apartament dhe se (iii) vlera prej 5.500.000 lekë, e deklaruar në D-Vett. dhe Deklaratën fillestare, përfaqësonte vlerën e apartamentit dhe garazhit*

6.8.1 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të germës “b”, të pikës 5.1, të Rekomandimit të ONM-së⁹, nga shqyrtimi i akteve në dosje konstaton se ky pretendim i subjektit i rivlerësimit mbetet i pabazuar, për arsye në vijim:

(i) Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k. dy kontrata shitblerje në të njëjtën datë, më ***.10.2004, njëra për pasurinë: “*Apartament 146 m²*”, të ndodhur në katin e 6 (gjashtë), me çmim shitje 1.700.000 lekë, dhe tjetra për pasurinë: “*Garazh 10m²*”, i ndodhur në katin nën dhe, me çmim shitje 250.000 lekë. Nënshkrimi i këtyre kontratave të ndryshme nuk mbështet pretendimin se dy pasuritë ishin përfshirë në një kontratë.

(ii) Subjekti ka dy certifikata pronësie të ndryshme, paguan për secilën nga pasuritë dy vlera të ndryshme, të dy pasuritë regjistrohen secila më vete në ZVRPP-në Durrës, aplikimi për regjistrimin e pasurisë: *Garazh 10 m²*, rezulton se është bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit.

⁹ “*Garazhi që nuk përmendet në kontratën e shitjes së apartamentit dhe as edhe në deklaratën e parë, ishte objekt i një kontrate të dytë shitje, nënshkruar nga subjekti në të njëjtën ditë me kontratën e shitjes së apartamentit, me çmim/vlerë kontratë 250.000 lekë, por e padeklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore.*”

6.8.2 Në përfundim për sa më sipër, referuar dispozitës së nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë mbi dy pasuritë e lartpërmendura.

6.9 *Për mungesën e të ardhurave të ligjshme nga burime të ligjshme për krijimin e pasurive: “Apartament banimi 146 m²” dhe “Garazh 10 m²”, dhe pasaktësitë mbi deklaramin e çmimit të paguar për pasurinë te shoqëria ndërtuese*

6.9.1 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të germës “c”, “d” dhe “e”, të pikës 5.1, të Rekomandimit të ONM-së, nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstaton se:

6.9.2 Subjekti i rivlerësimit, në *D-Vett.* dhe *Deklaratën e parë (dorëzuar në datën 24.3.2004)* deklaroi si burime të krijimit të pasurive: (i) kursimet e të ardhurave dhe (ii) pjesëtimin vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000. Në *D-Vett.* deklaroi se vlera sipas aktit të porosisë në vitin 2001, është 5.500.000 lekë, dhe për arsye të mospërfundimit të banesës, në aktet e shitblerjeve, vlera e apartamentit (karabina) është 1.700.000 lekë dhe garazhi 250.000 lekë, shpenzime të cilat janë kryer më pas për punimet.

6.9.3 Sa më lart trajtuar, subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë blerë një apartament të përfunduar (*ashtu sikurse konfirmon dhe leja e shfrytëzimit, që daton në v. 2000, e cila ka bërë të mundur regjistrimin e apartamentit në ZVRPP- në Durrës*), për një çmim total prej 5.500.000 lekë, sikurse është deklaruar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në *Deklaratën e parë*. Këto rrethana të provuara, referojnë faktin se në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, në muajin tetor 2004, çmimi i shitjes nuk pasqyrohet atë real.

6.9.4 *Për burimin: “pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000”, në zbatim edhe të pikës 5.1, germa “c” (ii)¹⁰ dhe germa “d” (i)¹¹; (ii)¹², të Rekomandimit të ONM-së, nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstatohet se:*

6.9.4.1 Në *D-Vett.* dhe *Deklaratën e parë*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se burim krijimi i pasurisë është edhe pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000, pa dhënë ndonjë vlerë konkrete të këtij pjesëtimi. Gjatë hetimit administrativ në Komision ka pretenduar se: *[...] Kam biseduar me prindërit që bashkëjetonin dhe me vëllain tim, në lidhje me nevojën që kisha për të ndihmuar për blerjen e apartamentit tim. Babai im, ***, ***, pasi shprehu gatishmërinë për të më ndihmuar, më dhuroi shumën prej 1.500.000 lekë [...]*¹³.

¹⁰ “Subjekti i rivlerësimit deklaroi në mënyrë të pasaktë si ndarje vullnetare atë që ai vetë më pas e shpjegoi se ishte një dhuratë e marrë nga i ati, për të korrigjuar veten përsëri më pas me deklaramin noteriale të vitit 2018, të paraqitur në KPK, në të cilën babai i tij – dhuruesi – tregon se shuma 1.500.000 lekë nuk ka rrjedhur nga shitja e banesës familjare, por gjithashtu nga remitanca të dërguara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, ***, nga puna e tij në Itali.”

¹¹ “nëse i ati i tij kishte kapacitet financiar për të bërë një dhuratë prej 1.500.000 lekë, duke marrë parasysh që në të njëjtat vite ai bleu një vilë të pretenduar të papërfunduar me tri kate, për çmimin prej 1.000.000 lekë, duke e përfunduar atë në vijimësi”

¹² “nëse vëllai i tij ***, kishte të ardhura të ligjshme duke justifikuar kontributin e tij në blerjen e apartamentit, duke marrë parasysh që - sipas provave të prodhuara nga vetë subjekti i rivlerësimit – del se vetëm në tetor 2002, pra shumë kohë pas dhurimit, ***, regjistroi veprimtarinë e tij në Itali: vlen të përmendet se para asaj kohe aktiviteti i vetëm i njohur fitimprurës i ***, ***, ishte përfshirja [në kryerjen e veprave penale red.im], për të cilin është shpallur fajtor dhe ka vuajtur dënimin”

¹³ Referohuni përgjigjes të pyetjes nr. 5, në pyetësorin nr. 2 të Komisionit.

6.9.4.2 Komisioneri Publik nënvizon faktin se sipas Formularit A-1, në *Deklaratën e parë*, rubrika: “Burim” ka shënimin: “konkret dhe jo i përgjithshëm”. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të deklaronte vlerën prej 1.500.000 lekë, të pretenduar si të përfituar nga pjesëtimi vullnetar i shitjes së banesës në vitin 2000.

6.9.4.3 Për sa i përket aftësisë financiare të z. ***.**, për dhurimin e shumë prej 1.500.000 lekë, nga shqyrtimi i akteve në dosje, përfundimi që arrin Komisioni¹⁴ konstatohet se nuk gjen bazueshmëri, për arsyet në vijim:

(i) në periudhën 2000-2002, babai i subjektit të rivlerësimit, z. ***.**, ka realizuar të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme: “Apartament banimi me sip. 65 m²”, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep. dhe nr.** kol., datë ***.12.2000, kundrejt vlerës prej 1.900.000 lekë dhe ka shpenzuar për blerjen e pasurisë së paluajtshme “Godinë 4 kt.”, sipas kontratës së blerjes me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.3.2002, kundrejt vlerës 1.000.000 lekë.

(ii) Z. ***.** ka investuar për përfundimin e “Godinës 4 kate”, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka qenë e përfunduar pjesërisht në kohën e blerjes dhe është përfunduar më pas nga blerësi, z. ***.**¹⁵.

(iii) Në emër të z. ***.**, pranë ***, më datë ***.10.2004, rezulton një llogari depozite në vlerën 1.000.000 lekë, e cila ka qenë e mbartur nga periudhat e mëparshme.

6.9.4.4 Gjithashtu vërejmë se në Deklaratën noteriale me nr.*** rep. dhe nr.** kol., datë ***.10.2018, z. ***.** deklaron se burimet për financimin e dhurimit ishin jo vetëm nga shitja e apartamentit, por edhe të ardhurat e dërguara nga emigracioni, gjatë asaj periudhe, prej vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit ***.**.

6.9.4.5 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, përcjellë nga autoritetet gjyqësore italiane, për efekt të procesit të rivlerësimit, vëllai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi ***.**, rezulton se në atë periudhë është dënuar me vendim të formës së prerë të autoriteteve gjyqësore italiane, për kryerjen e dy veprave penale, në territorin e Republikës së Italisë.

6.9.4.6 Këto rrethana kanë ndikim në analizimin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të ligjshme të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, burime, të cilat deklarohen të jenë përdorur për krijimin e pasurisë dhe që nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues ligjor, për të vërtetuar ndonjë burim alternativ të ligjshëm të krijimit të tyre nga shtetasi ***.**.

6.9.5 *Për burimin e të ardhurave të ligjshme për dhuratat e pretenduara të marra nga z. ***.** (babai i bashkëshortes së subjektit) dhe z. ***.** (vëllai i bashkëshortes së subjektit),*

¹⁴Referohuni pikës 24.35, f.12 e vendimit të Komisionit.

¹⁵Referohuni pikës 24.38, f.12 e vendimit të Komisionit.

Komisioneri Publik, në zbatim edhe të pikës 5.1, germa “c” (iii)¹⁶ dhe germa “d” (iii)¹⁷, të Rekomandimit të ONM-së, nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstaton se:

6.9.5.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, sikundër është trajtuar në shkaqet e ankimit, pretendoi se ka marrë dhurata nga: (i) z. ***.*** shumën 1.000.000 lekë; (ii) z. ***.***, 300.000 lekë; si dhe (iii) ka përdorur shumën 350.000 lekë të bashkëshortes, marrë si dhuratë nga familja e saj, për martesë.

6.9.5.2 Për sa i përket këtyre të ardhurave, nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstatohet i pambështetur përfundimi që arrin Komisioni¹⁸, për arsyet në vijim:

(i) Subjekti i rivlerësimit, për të provuar aftësinë financiare të z. ***.***, për shumën 1.000.000 lekë, ka paraqitur 3 kontrata shitblerje trualli për periudhën 1996-2001, në shumën totale prej 3.240.000 lekë¹⁹. Ndërkohë, Komisioni nuk analizon se në të njëjtën periudhë (1996-2000) z. ***.***, babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ka investuar në ndërtimin e “*Banesës 4 kate*”, shitur në vitin 2002, babait të subjektit të rivlerësimit.

(ii) Gjithashtu, shuma totale prej 3.240.000 lekë, po t’i referohemi deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, do të pakësohej, pasi pretendohet fakti se z. ***.*** i ka dhuruar *cash* para martese znj. ***.***, bashkëshortes së subjektit, shumën 350.000 lekë, shumë e padëklaruar më parë dhe që mbetet në nivel deklarativ.

(iii) Subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në shpjegimet e tij, kur i referohej formës së kontributit të pretenduar (dhuratës), të marrë nga i vëllai i bashkëshortes. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kontributi i tij ishte në natyrë, në funksion të rregullimit të banesës, ndërsa në seancën dëgjimore të datës 27.6.2019, në përgjigje të pyetjes së përfaqësuesit ndërkombëtar për të qartësuar formën e kontributit të kunatit, ky pretendim ka ndryshuar, pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kunati kishte paguar për punimet ndërtimore në apartament, vlerën prej 300.000 lekësh.

6.9.6 *Për burimin e deklaruar: “kursimet e të ardhurave”, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve në dosje, vëren se:*

6.9.6.1 Nga analiza financiare e Komisionit, për periudhën 1992-2003, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve për krijimin

¹⁶ “Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të deklarojë dhurimin e shumës 300,000 lekë nga kunati i tij. Ai është, gjithashtu, kontradiktor në lidhje me burimin e të ardhurave, pasi ai, për herë të parë, e tregoi atë në përgjigjen e tij në pyetësorë si një “dhuratë në natyrë” për shumën prej 300.000 lekë, por më vonë ai e përshkroi atë si një kontribut monetar për përfundimin e punimeve ndërtimore. Mungesa e deklarimit të këtij dhurimi nuk shpjegohet nga subjekti i rivlerësimit dhe justifikimi i tij, se nuk kishte vend të veçantë në formularin e deklaratës për ta deklaruar, bie poshtë nga fakti që Deklarata e parë, ato periodike dhe ajo “Vetting” shoqërohen nga të njëjta udhëzime, të cilat specifikojnë detyrimin për të deklaruar të gjitha dhuratat dhe të gjitha burimet e krijimit të pasurive.”

¹⁷ “Nëse kunati, ***.***, kishte kapacitetin financiar për të financuar shumën 300,000 lekë, dhuruar subjektit të rivlerësimit për financimin e punimeve në apartamentin e tij.”

¹⁸ Referohuni pikës 24.44, si dhe pikës 24.46, f.13 -14 të vendimit të Komisionit.

¹⁹ Referohuni faqes 13 të vendimit të Komisionit, paragrafi 24.43.

e të ardhurave të ligjshme në shumën - 163.765 lekë, pasi duket se nga ana e Komisionit i janë marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e tij mbi burimet e krijimit të pasurisë.

6.9.7 Komisioneri Publik, ashtu sikurse është argumentuar dhe në germën “e”,²⁰ të pikës 5.1, të Rekomandimit të ONM-së, për sa më lart trajtuar, vlerëson se nuk duhet të konsiderohen në mesin e të ardhurave të ligjshme dhurimet e pretenduara nga të afërmit e subjektit të rivlerësimit, në shumën totale 3.150.000 lekë²¹. Gjithashtu, konstatojmë se në analizën financiare të Komisionit, shpenzimet e jetesës janë marrë në konsideratë për periudhën 1997-2003, ndërkohë duheshin konsideruar për periudhën 1992-2003, periudhë në të cilën i janë marrë në konsideratë të ardhurat. Në këto kushte, balanca negative e të ardhurave të ligjshme për subjektin e rivlerësimit, për periudhën 1992-2003, arrin në vlerën - 4.230.853 lekë.

6.10 Komisioneri Publik, në përfundim të analizës së provave/akteve të administruara në dosjen e Komisionit për pasurinë: “Apartament 146.43 m²” dhe pasurinë “Garazh 10m²”, vlerëson se referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe në mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga subjekti i rivlerësimit.

7. Investimi në “Fondin e Investimeve *”, në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank (***), dhe për krijimin e gjendjes cash në banesë, të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë**

7.1 Në *D-Vett.*, subjekti deklaron: Depozitim në *** (fond investimi) 5.500.000 lekë dhe gjendje *cash* në banesë 1.200.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursimet nga të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes.

7.2 Në *DV-2014*, subjekti deklaron: Depozitim në ***, në vlerën 4.000.000 lekë (blerje kuotash), mbetur gjendje *cash* në banesë shuma 2.400.000 lekë, dhe shtuar *cash*-i në banesë 400.000 lekë. Burimi i krijimit: Nga kursimet vjetore të deklaruara periodikisht si *cash* në banesë, dy llogaritë bankare 8.000 USD, në ***,***.*** Bank si dhe 1.079.132 lekë, tërhequr nga llogaria e pagës.

7.3 Në *DV-2016*, subjekti deklaron: Depozitim në ***, në vlerën 1.500.000 lekë, si fond investimi, duke ia shtuar vlerës së mëparshme të deklaruar në vitin 2014. Burimi i krijimit: nga gjendja *cash* në banesë, në datën ***.10.2016.

7.4 Referuar rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, z. Madani, barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse për krijimin e depozitës *** dhe gjendjes *cash* në

²⁰ “Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për financimin e këtyre pasurive. Vetëm pas deklaratës “Vetting”, ai pretendoi që ka marrë dhurime dhe kontribute të konsiderueshme (në veçanti: dhurime nga vjehri, në shumën 1.000.000 lekë, dhurimi i shumës 300.000 lekë nga kunati; kursime të gruas në shumën 350.000 lekë, të cilat janë përmendur/listuar nga subjekti për të justifikuar pamjaftueshmërinë/mungesat financiare në vitin 2003, si dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të depozitës në ***.4.2006. Sipas nenit D, paragrafi 3 i aneksit të Kushtetutës, të ardhurat që mund të merren në konsideratë për të justifikuar pasuritë, vetëm nëse janë deklaruar. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte ekzistencën dhe ligjshmërinë e këtyre kontributeve.”

²¹ Dhurimet: (i) 1.500.000 lekë nga babai i subjektit; (ii) 1.000.000 lekë nga vjehri; (iii) 300.000 lekë nga kunati, (iv) 350.000 lekë e deklaruar si e ardhur nga ana e bashkëshortes në momentin e martesës, si kursime të saj nga puna dhe dhuratë nga familja.

banesë, si edhe për pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të dalë pas analizës financiare për periudhën 2004-2016, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje dhe ka paraqitur dokumentacion në materialin: *Shpjegime ndaj rezultateve të hetimit*, të datës 22.6.2019.

7.5 Në përfundim, Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka ardhur në përfundimin se: [...] *pas analizës financiare të përditësuar mungesa e likuiditeteve (balancat negative), të shtrira përgjatë viteve, nuk janë në masën që të cenojnë besimin e publikut. Ky përfundim arrihet pasi natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale. Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se mungesa e këtij likuiditeti (balancë negative fondesh) nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit [...]*²².

7.6 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të pikës 5.2, të Rekomandimit të ONM-së, si dhe nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstaton se deklaratimet e subjektit mbi investimin në “Fondin e Investimeve ***” dhe për krijimin e gjendjes *cash* në banesë, konstatohen si të pasakta dhe të pamjaftueshme. Nga aktet e administruara, duket se Komisioni ka pranuar si provë analizën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, analizë e cila, në më shumë se një rast, paraqitet kontradiktore me vetë deklaratimet e subjektit, dhe nuk mbështetet në një logjikë ekonomike për sa në vijim:

(i) parametrat e përdorura nga subjekti i rivlerësimit në përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, për të kundërshtuar analizën financiare të Komisionit, nuk ndjekin një metodologji të logjikshme dhe subjekti i rivlerësimit i zbaton ato në mënyrë jo konsistente në analizën e tij²³, duke pretenduar të përshtatë shpenzimet, sipas gjendjes së tij financiare;

(ii) subjekti i rivlerësimit ka përfshirë në analizën e tij si të ardhurat e pretenduara dhe të padeklaruara më parë në Deklaratat periodike vjetore²⁴, ashtu dhe të ardhurat e deklaruara, duke krijuar mospërputhje mes deklaratimeve periodike vjetore, në raport me të dhënat e analizës financiare;²⁵

(iii) shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit janë përllogaritur sipas një metodologjie të ndryshme nga metodologjia orientuese e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,²⁶ në disa raste duke rënë ndesh dhe me vetë deklaratimet e subjektit,²⁷ duke i përshtatur shpenzimet e udhëtimit sipas gjendjes së tij financiare;²⁸

²² Referohuni pikës 25.14, faqe 18 e vendimit të Komisionit.

²³ Referohuni germës “a”, pika 5.2 e Rekomandimit.

²⁴ Të ardhura për periudhën 2004-2016 rezultojnë të jenë përafërsisht në shumën 1.072.730 lekë, konkretisht: deklaruar në DV-2007, dhuruar nga kunati shuma 500 euro; shuma prej 350.000 lekë të depozituara më datë ***.4.2006, nga bashkëshortja e subjektit, në ***, si dhe shuma prej 250.000 lekë, të depozituara më datë ***.2.2007, nga z. ***.***, të dyja këto shuma të padeklaruara; shuma prej 3.000 euro, deklaruar në DV-2015, pagesa e shkollimit të vajzës nga z. ***.***.

²⁵ Referohuni germës “b”, pika 5.2 e Rekomandimit.

²⁶ Referohuni vendimit nr. (JR) 11/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²⁷ Siç është rasti i udhëtimit në Greqi, ku subjekti në pyetësorin e parë ka deklaruar shpenzime në vlerën 2.500 euro dhe pas rezultateve të hetimit ka deklaruar shpenzime udhëtimi në vlerën 1.500 euro.

²⁸ Referohuni germës “c”, pika 5.2 e Rekomandimit.

(iv) subjekti i rivlerësimit, vetëm pas rezultateve të hetimit, pretendoi se i ati i tij, z. ***.***, ndër të tjera, si burime të të ardhurave kishte dhe interesat e kthyera nga firmat piramidale. Këto pretendime nuk u provuan nga subjekti me dokumentacion provues ligjor, por u dokumentuan vetëm shpenzimet e investimit në këto firma;²⁹

(v) shpenzimet e jetesës për vitin 2007³⁰ nuk janë llogaritur referuar të dhënave sipas korrespondencës me ILDKPKI-në;

(vi) shpenzimet e rivlerësimit të pasurisë “Apartament banimi 146 m²” për vitin 2011³¹, nuk janë përlllogaritur në zërin shpenzime;

(vii) vlerat e përfituara nga bonusi i karburantit dhe dietat, përlllogaritur në zërin “të ardhura”, nuk janë në përputhje me metodologjinë orientuese të Kolegjit ³².

7.6.1 Komisioneri Publik, duke marrë parasysh konkluzionet e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së³³, si dhe aktet e administruara në dosjen e Komisionit, konstaton se:

(i) Deklarimet e subjektit mbi ndryshimet e likuiditeteve ndër vite nuk justifikohen me të ardhura të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi financiare, për sa ai ka deklaruar, për të akumuluar: (a) shumën 2.400.000 lekë në *cash*³⁴, të mbetura pas krijimit të investimit në “Fondin ***”, në shumën 4.000.000 lekë, më datë ***.1.2014, ashtu sikurse ai ka deklaruar; (b) shumën prej 1.500.000 lekë, të investuar më datë ***.10.2016 në ***, si dhe (c) shumën e deklaruar si gjendje *cash* në D.Vett., për vlerën 1.200.000.

(ii) Duke marrë në konsideratë të gjitha elementet e sipërpërmendura, vlerëson se balanca negative e fondeve për subjektin e rivlerësimit për periudhën 2004-2016 do të arrinte në vlerën - 4.333.111 lekë.

7.6.2 Në përfundim, Komisioneri Publik, referuar balancës negative të fondeve për periudhën 2004-2016, çmon se, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe mungesës së burimeve të ligjshme për investimin në “Fondin e Investimeve ***”, në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank, dhe gjendjes *cash* në banesë, të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë.

²⁹ Referohuni gërmës “d”, pika 5.2 e Rekomandimit.

³⁰ Reduktimi i shpenzimeve të jetesës për vitin 2007 ka bërë që rezultatet e analizës financiare në këtë vit nga një balancë negative në vlerën - 490.661 lekë, referuar rezultateve të hetimit administrativ, të arrijnë në një balancë pozitive në vitin 2007, referuar vendimit të Komisionit, prg. 25.11.

³¹ Shpenzime rivlerësimi banese në vitin 2011, në vlerën 89.834 lekë.

³² Referohuni vendimit nr. (JR) 7/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Vlera e bonuseve të pretenduara arrin gjithsej në vlerën 350.000 lekë, ndërsa vlera e dietave arrin shumën 999.500 lekë.

³³ Referohuni paragrafit 5.2, germa “e”, e Rekomandimit të ONM-së: “Në përfundim, deklarimi i subjektit të rivlerësimit mbi ndryshimet e likuiditeteve ndër vite, tregojnë se ai ka akumuluar më shumë burime, sesa ai ishte në gjendje të justifikonte me të ardhurat e tij. Kjo nënkupton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të akumuluar 2.400.000 lekë në *cash*, në fund të vitit 2014, siç është deklaruar, që nënkupton që nuk mund të justifikohet shuma prej 1.500.000 lekë, e investuar në ***.10.2016, në *** dhe gjendja e *cash*-it, në shumën 1.200.000 lekë, të deklaruar në Deklaratën Vetting.”

³⁴ Shumë e cila është investuar në vitin 2016, në “Fondin e Investimit ***”, në shumën 1.500.000 lekë dhe së bashku me deklarimet *cash* të vitit 2014-2015, në vitin 2016 rezultojnë të deklaruara në 1.200.000 lekë, të deklaruara dhe në D.Vett.

8. Pasuria e luajtshme autoveturë, me targë AA***

8.1 Subjekti i rivlerësimit në D-Vett., dorëzuar më datë 26.1.2017, nuk deklaroi pasuri të luajtshme në pronësi apo përdorim të tij apo të personit të lidhur.

8.1.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: [...] *ka përdorur një automjet "Ford", me targa AA***, me raste të veçanta, për udhëtime kryesisht lëvizje/udhëtime familjare, i cili është në pronësi të z. ***.***, mik i familjes, sipas një akti përdorimi të veçantë në vitet 2014-2016, i revokuar pas janarit 2017 [...]*³⁵.

8.1.2 Referuar rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni ka ngritur dyshimin se ky automjet është i subjektit të rivlerësimit dhe jo i shtetasit ***.***, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse në lidhje me këtë automjet, si dhe mbi dyshimet e ngritura si më sipër, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje dhe paraqitur dokumentacion në materialin: *Shpjegime ndaj rezultateve të hetimit*, të datës 22.6.2019.

8.1.3 Pasi ka administruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në materialin: *Shpjegime ndaj rezultateve të hetimit*, të datës 22.6.2019, Komisioni, vlerësoi se: [...] *deklarimet e subjektit lidhur me pronësinë dhe me përdorimin e këtij automjeti duken bindëse. Rezultoi e provuar se shtetasi ***.*** është pronari i dy automjeteve dhe ka pasur mundësi financiare për blerjen e tyre. Nuk disponohen të dhëna që shtetasi i sipërcituar, i cili i ka dhënë në përdorim këtë automjet, të jetë me rekorde kriminale, i përfshirë në krimin e organizuar ose i dyshuar si i përfshirë në krimin të organizuar. Komisioni konstaton se nuk qëndrojnë dyshimet e ngritura paraprakisht me rezultatet e hetimit [...]*³⁶.

8.1.4 Referuar pikës 5.3, të Rekomandimit të ONM-së, dhe akteve të administruara në dosje të Komisionit, duket se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, nuk ka arritur të kundërtën e barrës së provës për të shpjeguar arsyet e mosdeklarimit të përdorimit të këtij automjeti, përkundër rrethanave të faktit që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ.

III. Kërkimi i ankimit

9. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, dispozitat e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të argumenteve të paraqitura nga Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, në aktin: *Rekomandim për paraqitje ankimi*, konstatohet se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

10. Referuar nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konstatohet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të

³⁵ Referohuni përgjigjeve të pyetësorit nr.1, në dosje të Komisionit.

³⁶ Referohuni pikës 26.6, f. 19 e vendimit të Komisionit.

aneksit të Kushtetutës, nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut, pasi: (i) nuk ka deklaruar saktë dhe mjaftueshëm të dhënat e pasurisë; (ii) nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme burimet e ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme për pasuritë në pronësi të tij, si dhe (iii) ka bërë përpjekje për të fshehur ose pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim të tij;

11. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

12. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA